



02Nr 7806 /2022
15.09.2022

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.06/L-114, neni 79.80 dhe 81 ,Ligjit të Punës Nr.03/L-212 neni 8, Udhëzimin Administrativ(MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, **Komuna Hani Elezit rishpallë:**

K O N K U R S

Për plotësimin e vendit të lirë të punës

Titulli i vendit të punës: Koordinator i punëtorëve teknik

Institucioni: Komuna Hani Elezit

Drejtoria: Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport

Njësia sektori: Shkolla fillore "Ilaz Thaçi" Hani i Elezit

Lloji i pozitës: Nëpunës administrativo-teknik

Numri i pozitave: Një (1) pozitë

Orari i punës: 40 orë në javë

Titulli i mbikqyrësit: Drejtori i shkollës

Koeficienti/Grada: koeficienti 5

Kohëzgjatja: Me kohë të caktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Kujdeset për mirëmbajtjen e objektit në pjesët e jashtme dhe të brendshme
2. Bën mirëmbajtjen e instalimit elektrik, ujit, inventarit dhe pajisjeve tjera
3. Në rast të defekteve të mëdha, mban kontakte me serviset e specializuara dhe asiston me rastin e riparimeve
4. Bën kyçjen dhe çkyçjen e nxemjes qendrore dhe gjeneratorit elektrik, duke mbajtur edhe evidencën e derivateve të naftës të cilat janë të deponuara në rezervuarët e këtyre pajisjeve
5. Mban evidenën. Kontrollon dhe monitoron rezervuarin e derivateve të cilat janë të vendosura në lokacionet e shkollës
6. Bën mirëmbajtjen e oborrit dhe përkujdeset për lulet brenda dhe përreth ndërtesës së shkollës
7. Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret

Kualifikimi dhe kushtet e pjesmarrjes në rekrutim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- Të ketë të kryer shkollën e mesme

Dokumentet e nevojshme:

- Formulari i aplikimit (merret në Komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë)
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë kopje).
- Diploma e kualifikimit (ose certifikata) duhet të jete kopje të vërtetuara.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime (nga gjykata)
- Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data 14.10.2022 deri 28.10.2022 (16:00).

Mirëpritën aplikacionet e femrave dhe meshkujve të të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

Konkursi dhe rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/> , në webfaqen e komunës <https://kk.rks-gov.net/haniielezit> dhe në tabelën e shpalljes.

